



RAPORTI I - VI - | PËR MUAJIN KORRIK 2010

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Raporti i Monitorimit mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë Kundër Korrupsionit

*“... lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të
organizuar është një parakusht thelbësor
për anëtarësimin e Kosovës në Bashkimin
Evropian...”*

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID-i përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Qëndrimet në këtë Raport nuk reflektojnë qëndrimet e USAID ose ISC.



PËRMBAJTJA

Përmbledhje.....	5
Hyrje.....	6
Qeveria e Kosovës.....	6
Kuvendi i Kosovës.....	9
Sistemi Gjyqësor.....	11
Prokuroria e Shtetit.....	12
Doganat e Kosovës.....	12
Policia e Kosovës.....	12
Raportimet e Gazetave.....	13
Raportet nga Shoqëria Civile.....	14
Lëvizja FOL.....	14
Instituti Demokratik i Kosovës.....	14
Instituti Ballkanik i Politikave.....	14
Falënderime.....	14
Rreth Lëvizjes “FOL”.....	15

LISTA E AKRONIMEVE

AAK – Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

AKK – Agjencia Kundër Korrupsionit

AKR – Aleanca Kosovare e Re

BQK – Banka Qendrore e Kosovës

BE – Bashkimi Evropian

DHKEK – Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit

EULEX – Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë

IKS – Iniciativa Kosovare për Stabilitet

IPOL – Instituti i Ballkanik i Politikave

ISC – Institute for Sustainable Communities (Instituti për Komunitete të Qëndrueshme)

KDI – Kosovo Democratic Institute (Instituti Demokratik i Kosovës)

LDD – Lidhja Demokratike e Dardanisë

MAP – Ministria e Administrimit Publik

MTPT – Ministria e Transportit dhe Telekomunikacionit

MM – Memorandum Mirëkuptimi

PDK – Partia Demokratike e Kosovës

PK – Policia e Kosovës

SSP – Sektori i Standardeve Profesionale

ZAP – Zyra e Auditorit të Përgjithshëm

PËRMBLEDHJE

Kuvendi i Kosovës ka mbajtur pesë seanca plenare, tri prej të cilave seanca solemne për: Tony Blair, fjalimi i Presidentit Sejdiu dhe mbështetja për Mendimin Këshillëdhënës të GJND-së. Nga statistikat për periudhën Janar-Korrik shihet se nga 104 pyetje sa janë parashtruar gjithsej, vetëm 41 prej tyre janë bërë për afera të ndryshme korruptive, ndërkaq 63 sosh janë bërë për çështje tjera. Gjatë këtij intervali kohor, deputetët më aktiv në denoncimin e aferave korruptive janë Driton Tali me 13 pyetje parlamentare, Naim Rrustemi me 10, Riza Smaka me 5 dhe Xhynaze Sylja me 2. Aktivitetet kryesore të Qeverisë së Kosovës për muajin korrik kanë qenë shkarkimi i zv. ministrit të Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës, Gjergj Dedaj, miratimi i Projekt-Ligjit për Prokurimin Publik dhe inicimi i nxjerrjes së Ligjit Anti-Mafia.

Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit në Kosovë ka arrestuar Ilir Tolaj-n, këshilltarin e ministrit Bukoshi dhe ka arrestuar Gani Zogajn, IT në Ministrinë e Administrimit Publik, me akuzën për shlyerjen dhe fshehjen e informacioneve për “rastin Limaj”. Megjithatë, të dy janë liruar, mirëpo hetimet për mbledhjen e fakteve ndaj tyre janë duke u vazhduar. EULEX-i ka paralajmëruar edhe për arrestime të tjera, duke përfshirë edhe arrestime në Mitrovicën e Veriut.

Task Forca Anti-Korrupsion, e cila vepron në kuadër të Prokurorisë Speciale, për herë të parë është funksionalizuar me rastin e arrestimit të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Kosovës, Hashim Rexhepi. Për herë të parë prokurorët vendorë janë angazhuar në një rast të tillë, të nivelit të lartë.

Policia e Kosovës ka filluar fushatën e saj anti-korrupsion përmes shpërndarjes së broshurave për sensibilizimin dhe vetëdijesimin e qytetarëve për denoncimin e aferave korruptive. Ka arrestuar edhe një zyrtar të pylltarisë në Komunën e Pejës, mirëpo është liruar nga gjyqtari i Gjykatës Komunale në Pejë, ani pse ka pasur fakte të mjaftueshme për dënimin dhe burgosjen e tij.

Nga 177 artikuj të publikuar nga gazetatat e përditshme (Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Express), vetëm 62 janë realizuar si tema, ndërkaq 115 prej tyre si lajme. Derisa Koha Ditore dhe Zëri janë fokusuar më shumë në kritikën ndaj Ekzekutivit të vendit dhe ndërmarrjeve publike, kritikën e Kosova Sot janë përqendruar më shumë në Gjyqësorin e Kosovës.

Në kuadër të Doganave të Kosovës janë shqiptuar 4 masa disiplinore dhe 4 zyrtarë tjerë janë suspenduar për shkak të shpërdorimit të detyrës zyrtare. Lëvizja FOL ka organizuar një tryezë të rumbullakët për “Konfliktin e Interesit”, në të cilën është publikuar edhe lista e deputetëve të cilët mbajnë edhe pozicione tjera të cilat paraqesin konflikt të pastër interesi. Instituti Demokratik i Kosovës ka publikuar Raportin e saj për Kuvendin e Kosovës dhe IPOL ka publikuar Raportin për rolin dhe funksionin e EULEX-it;

Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar në institucionet publike ka alarmuar edhe deputetët e Parlamentit Evropian. Në Rezolutën e miratuar për Kosovën është kërkuar që viti 2010 të jetë viti i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

HYRJE

Korrupsioni, i vlerësuar si sfida kryesore për shoqërinë e Kosovës përgjatë 11 viteve të transicionit, vazhdon të mbetet shqetësim i përbashkët i të gjithëve: politikanëve, shoqërisë civile e mediave. Ndërkombëtarët adresojnë këtë çështje në raportet/vlerësimet e tyre të përvitshme dhe qëndrimet deklarative. Bashkimi Evropian me Raportet e Progresit, e Departamenti Amerikan i Shtetit me raportet periodike për çështje të veçanta, mbesin vërejtjet publike që Kosova i merr pothuajse rregullisht viteve të fundit. Ndërsa raportet e organizatave jo qeveritare ndërkombëtare për Kosovën, kanë qenë të vazhdueshme dhe shpesh herë më të ashpra në adresimin e korrupsionit.

Vendasit mbeten të ndarë në qasjen për korrupsionin dhe luftën kundër tij. Përderisa pushtetarët zotohen për 'zero tolerancë korrupsionit dhe krimin të organizuar', opozita adreson të kundërtën, duke e cilësuar 'qeverinë – koka e korrupsionit'. Qëndrimet e tyre për çështjen në fjalë ndryshojnë me ndërrimin e pushtetit, e bashkë me të edhe rolet e tyre. Përgjatë qeverisjes nën administrimin e UNMIK-ut, dhe pas shpalljes së pavarësisë, publiku kosovar në rolin e spektatorit ka mundur të përcjell rokadën e pushtetit dhe retorikën pothuajse boshe për luftën kundër korrupsionit. Çështja e statusit, e më pas bërja e shtetit, janë shndërruar Atutë kryesore pas të cilave politikanët kosovarë janë fshehur vazhdimisht.

Dy vite pas shpalljes së pavarësisë, raportimet investiguese të medieve për korrupsionin, instalimi i Misionit të BE-së për Sundimin e Ligjit, EULEX, dhe forcimi i thirrjeve të shoqërisë civile, kanë prioritetizuar 'luftën kundër korrupsionit'. Edhe pse arrestimi i 'peshqve të mëdhenj' është zëvendësuar me të vegjlit, madje në nivel komunal, pritjet që ndërkombëtarët dhe Kryeministri Thaçi kanë krijuar

për qytetarët, do ta shoqëroj edhe për një kohë politikën ditore në Kosovë.

Lëvizja FOL vazhdon monitorimin e aktiviteteve të institucioneve publike në luftën kundër korrupsionit. Në periodikun e gjashtë me radhë, për muajin korrik, janë shënuar një sërë aktivitete. E tëra që mund të evidentohet gjatë këtij muaji është shkarkimi i zv. ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit Gjergj Dedaj, arrestimi i Ilir Tolaj-këshilltar i ministrit të Shëndetësisë, arrestimi i Governorit të Bankës Qendrore, Hashim Rexhepi, si dhe disa aktivitete me rëndësi dytësore.

QEVERIA E KOSOVËS

Qeveria e Kosovës, përgjatë tërë muajit korrik, ka qenë kryesisht e orientuar në Mendimin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Megjithatë, përpjekjet dhe zotimet e saj janë shtrirë edhe në drejtim të luftës kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar: janë ndërmarrë disa veprime/aktivitete që kanë të bëjnë me reduktimin e mundësisë së abuzimit me paranë publike dhe autoritetin zyrtar. Në vazhden e aktiviteteve të saj është edhe shkarkimi i fundit i zv. ministrit të MTPT-së, Gjergj Dedaj, miratimi i Projekt-Ligjit për Prokurimin Publik si dhe propozimi për nxjerrjen e Ligjit Anti-Mafia. Shkarkimi i z. Dedaj ka ardhur dy ditë pas emërimit të tij në postin e zv. ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës¹, duke shënuar njëkohësisht afatin rekord të shkarkimit të një zyrtari të lartë publik. Shkarkimi i tij ka ardhur menjëherë pas deklarimeve në media se Gjergj Dedaj, gjersa kishte qenë zv. ministër i Punës dhe Mirëqenies Sociale, kishte abuzuar me paranë publike të qytetarëve të Kosovës. Për vetëm 11 muaj Gjergj

¹ Petrit COLLAKU – Kosovë: Zyrtari i shkarkuar pas disa ditëve emërimi, www.balkaninsight.com, 16 korrik 2010

Dedaj kishte shfrytëzuar 33 mijë euro nga kredit-kartelat e Qeverisë dhe mbi 8 mijë euro tjera avance pa mbulesë.² Kanë qenë pikërisht këto fakte, sipas zyrtarëve të lartë qeveritarë, që kanë ndikuar në shkarkimin e tij.³ Ky veprim, sipas komunikatës së Qeverisë, vjen në vazhden e luftës së pakompromis ndaj korrupsionit, dukurive negative dhe është në funksion të fuqizimit të qeverisjes së mirë, transparente dhe efektive, në shërbim të interesave të qytetarëve të vendit.⁴ Megjithatë, “rasti Dedaj” dëshmon edhe njëherë që ndërrimet me aktin e “riformimit të Qeverisë” nuk kanë ngjarë për arsye se ministrat dhe zv. ministrat e shkarkuar kanë abuzuar me autoritetin dhe paranë publike, por kanë qenë vetëm ndryshime kozmetike. Në qoftë se Qeveria e Kosovës ka qenë në dijeni për këto abuzime, atëherë nuk është dashur që ta ri-emërojë Dedaj-ni në postin e zv. ministrit të Ministrisë së Transportit dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Edhe pse shihet qartazi që Gjergj Dedaj ka keqpërdorur pozicionin e tij, ndaj tij ende nuk është ndërmarrë asgjë konkrete për ndjekjen penale të tij. Nuk mjafton vetëm shkarkimi i tij nga funksionet qeveritare, por duhet të ndiqet edhe penalisht për veprimet korruptive të kryera. Në të kundërtën mund të shndërrohet në një precedent për zyrtarët tjerë të involvuar në afëra të ndryshme korruptive. Në qoftë se Qeveria e Kosovës është e bindur dhe e sigurtë në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, atëherë duhet të shkarkojë edhe ministrat tjerë të involvuar në afëra të ndryshme korruptive dhe kriminale. Pastrimi i Qeverisë nga këta ministra do të mundësonte një shfrytëzim më të arsyeshëm dhe më të mirë të financave publike dhe do të ndikonte në rritjen e besueshmërisë së

² Arsim RASHITI: Gjergj Dedaj, mijëra euro pa mbulesë, gazeta Zëri, 14 korrik 2010, fq. 1

³ Memli KRASNIQI: Dedaj shkarkohet dy ditë pas emërimit, gazeta Zëri, 16 korrik 2010, fq. 8

⁴ Gazeta Express: Kërcënon Thacin, 16 korrik 2010, fq. 5

qytetarëve ndaj institucioneve të Kosovës. Niveli i lartë i korrupsionit dhe krimit të organizuar në instancat më të larta qeverisëse ka alarmuar edhe ish-Kryeministrin britanik, Tony Blair. Thirrja e tij ka qenë që institucionet e Kosovës ta luftojnë korrupsionin dhe krimin e organizuar, sepse vetëm në këtë mënyrë Kosova mund të përqafojnë vlerat demokratike, mund të zhvillohet ekonomikisht dhe të integrohet në strukturat euro-atlantike. Blair ka thënë se korrupsioni gërryen mbështetjen popullore për shtetin, minon paaftësinë dhe punën e madhe, ndaj edhe mungesa e tij është një parakusht thelbësor për anëtarësim në Bashkimin Evropian.⁵ Edhe deputetët e Parlamentit Evropian janë shprehur të brengosur për nivelin dhe shtrirjen e korrupsionit dhe krimit të organizuar në institucionet publike. Në Rezolutën e miratuar nga Parlamenti Evropian është theksuar që vitit 2010 është qenësor, për Qeverinë e Kosovës dhe për të gjitha nivelet e administratës, për të përparuar në reformat kyçe.⁶ Edhe Presidenti i Bashkimit Evropian, Herman van Rompuy, ka porositur lidërsipin politik të Kosovës për ta luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, sepse kjo luftë nënkupton zhvillimin e Kosovës dhe nxitë përparimin social e ekonomik të saj.⁷ Edhe partitë opozitare kanë kritikuar Qeverinë për praktikat deformuese të keq-qeverisjes. Kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Qeveria Thaçi duhet të largohet, sepse duke filluar nga kryeministri, ministrat, kompanitë publike dhe tërë sistemi janë nën hetime. Qëndrim gati të ngjashëm ka mbajtur edhe Aleanca Kosovare e Re (AKR). Sipas zv. Presidentes, Mimoza Kusari-Lila, lufta ndaj

⁵ Deklarimi i Tony BLAIR me rastin e mbajtjes se fjalimit të tij në Kuvendin e Kosovës. Me gjerësisht shih Transkriptin e Mbledhjes Soleme të Kuvendit të Kosovës. 9 korrik 2010.

⁶ Valmir KLAIQI: Rezoluta e Njohjes, gazeta Express, 9 korrik 2010, fq. 4

⁷ Deklarimi i Presidentit Herman van ROMPUY me rastin e takimit të tij me Presidentin e Kosovës, Fatmir SEJDIU, Zëri, 7 korrik 2010

korruptionit është kthyer në betejë politike në mes të institucioneve vendëse dhe ndërkombëtare, e gjitha kjo në dëm dhe në huti të popullit të Kosovës.⁸ Ndërkaq, Misioni i BE-së për Sundim të Ligjit në Kosovës ka thënë se është duke hetuar 38 rastet e profilit të lartë, qoftë në nivel lokal, qoftë në atë qendror apo ndërkombëtar. Sipas kryeprokurorit të EULEX-it, Johannes van Vressëijk, aktualisht është duke u punuar në rastin e tetë dhe në një të ardhme të afërt priten arrestime të reja, duke përfshirë edhe Mitrovicën e Veriut. EULEX-i njashtu ka bastisur edhe Postë Telekomin e Kosovës me dyshimin e keqmenaxhimit dhe ka arrestuar IT e Ministrisë së Administrimit Publik (MAP), Gani Zogaj-n për shkak të dyshimeve që ka shlyer informacionet e kërkuara nga EULEX-i në “rastin Limaj”, por më pastaj është liruar, ani pse ai vazhdon të jetë ende i dyshuar për akuzat në fjalë. Ndërkaq, Paneli i gjyqtarëve të EULEX-it ka dënua Ove Johansen me 2 vjet me kusht dhe 300.000 euro për dëmin e shkaktuar PTK-së gjersa kishte punuar si menaxher i Norway Invest R&O AS. Ai në bashkëveprim me Leme Xhemën, Mustafa Nezirin, Roger Reynolds dhe Ronny Sorensen, me qëllim që vetës t’i sjellin përfitime materiale të kundërligjshme, ka kontribuar në sjelljen personale të Leme Xhemës, e cila ka shpërdoruar pozitën zyrtare si menaxhere gjenerale të PTK-së, duke lëshuar një urdhëresë për pagesë të paligjshme prej 300.000 eurove për kompaninë Norway.⁹ Gjatë këtij muaji është miratuar edhe Projekt-Ligji për Prokurimin Publik. Sipas këtij projekt-ligji kontratat me vlerë më të mëdha se 10 mijë euro duhet të nënshkruhen edhe nga ministri. Këtë e kanë kundërshtuar dy ministra (Ahmet Shala dhe Besim Beqaj). Ky i fundit ka thënë se me këtë kompetencë dhënë zyrtarëve qeveritarë po ndërhyhet politikisht drejtpërdrejt në procesin e

⁸ Bukurie BAJRALIU: AKR: Limaj po luan me ndjenjat e qytetarëve, Koha Ditore, 3 korrik, 2010, fq. 6

⁹ Besa KALAJA: Ove Johansen dënohet me kusht, gazeta Zëri, 10 korrik, 2010, fq. 8

prokurimi.¹⁰ Megjithatë, përmes kësaj dispozite do të ngritët llogaridhënia dhe përgjegjshmëria e ministrave, por kjo do të ndikojë që ministrat të mos shfajësohen për aferat korruptive, duke deklaruar se “fajin e kanë ata në prokurim”. Tolerimi i korruptionit në 11 vjetët e kaluara, apo heshtja ndaj kësaj dukurie i ka sjellë dëme vendit tonë, buxhetit tonë, mirëqenies së qytetarëve dhe imazhit të Kosovës. Luftimi i korruptionit dhe i krimin të organizuar, sipas tij, ka filluar të ndodhë vetëm tani, ndërsa do të zgjasë për një kohë të gjatë.¹¹ Kryeministri Thaçi, në mbledhjen e 14 korrik-ut 2010, ka pohuar se tashmë ka filluar procedura për nxjerrjen e ligjit Anti-Mafia, me synimin që përmes tij të goditen të gjitha format e kriminalitetit.¹² Një ligj i tillë ishte rekomanduar edhe nga Raporti Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane, në të cilin thuhej se baza ligjore është e pamjaftueshme për ta luftuar korruptionin - si rrjedhojë e zbrazëtirave ligjore, ngase Kosova ende nuk e ka Ligjin Anti-Mafia” ose një ligj i cili do të konfiskonte pasuritë që janë fituar në mënyrë të paligjshme.¹³ Nëse Thaçi e ka njëmend këtë luftë, atëherë duhet të fillojë nga rrethi më i lartë qeveritar, duke bërë shkarkimin e ministrave të dyshuar për afera korruptive. Ky ka qenë edhe konkluzioni që ka rezultuar nga tryeza e rumbullakët e Klubit për Politikë të Jashtme të Kosovës.

¹⁰ Besnik KRASNIQI: Qeveria përligj dorën e politikës në tender, Koha Ditore, 8 korrik, 2010, fq. 3

¹¹ Visar PIREVA: Thaci: Tolerimi i korruptionit I ka sjellë dëme vendit, Koha Ditore, 8 korrik, 2010, fq. 7

¹² Deklarimi i Kryeministrit THACI në mbledhjen e rregullt të Kabinitit të tij, RTK - Edicioni i Lajmeve (19:30), 14 korrik, 2010

¹³ David L. PHILLIPS – Të Kuptuarit e Pavarësisë së Kosovës, Këshilli Kombëtar mbi Politikën e Jashtme Amerikane, Neë York, 1 Maj, 2010, fq. 7

KUVENDI I KOSOVËS

Kuvendi i Kosovës, gjatë muajit korrik, ka mbajtur pesë seanca plenare, tri prej të cilave kanë qenë mbledhje solemne: fjalimi i Tony Blair-it, fjalimi i Presidentit të Kosovës dhe mbështetja për Mendimin Këshillëdhënës të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Gjatë këtyre seancave nuk është vërejtur përkushtim i madh nga ana e deputetëve për të ngritur/denoncuar afëra të ndryshme korruptive. Megjithatë, në seancën e fundit, të mbajtur për privatizimin e Postës dhe Telekomit të Kosovës, deputetët janë përfshirë në diskutime të shumta nëse duhet të privatizohet PTK-ja apo jo. Kritika të shumta ndaj Qeverisë dhe strategjisë së saj kanë ardhur edhe nga deputetët e koalicionit qeverisës. Kjo ka bërë që strategjia të mos e marrë miratimin në parim, por është dakorduar që të ndryshohet sipas vërejtjeve dhe sugjerimeve të deputetëve dhe më pastaj të sillen përsëri në shtator. Gjatë kësaj seance deputetët e opozitës nuk kanë marrë pjesë, me përjashtim të deputetit Riza Smaka, i cili po ashtu ka kritikuar ashpër strategjinë e Qeverisë për privatizimin e PTK-së. Gjatë këtij muaji janë ngritur kryesisht shqetësime që kanë të bëjnë me çështje politike dhe janë miratuar disa Raporte të institucioneve të ndryshme. Ndërkaq, për dallim nga seancat e kaluara, në kohën e pyetjeve parlamentare nuk është bërë asnjë pyetje për korrupsion, por vetëm për çështje tjera. Megjithatë, statistikave e gjashtë mujorit të parë dëshmojnë që deputetët nuk kanë adresuar shumë pyetje parlamentare për korrupsion. Në bazë të nenit 26.1 të Rregullores së Punës së Kuvendit¹⁴, koha për pyetje parlamentare është e kufizuar në 50 minuta. Kjo kohë është pothuajse e ngjashme me interpelancat parlamentare, ku deputetët mund t'i shprehin brengat dhe hallet e qytetarëve të Kosovës. Sipas statistikave të treguara më poshtë rezultojnë që deputetët nuk kanë adresuar edhe aq shumë

¹⁴ Neni 26.1. i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, miratuar me 20 Maj 2005, e ndryshuar dhe e plotësuar me 1 Qershor 2006.


çështjet që i mundojnë qytetarët e vendit. Sipas Raportit të Paralajmërimit të Hershëm të UNDP-së, niveli i korrupsionit përbën njërin ndër tre shqetësimet kryesore, së bashku me papunësinë dhe varfërinë.¹⁵ Mirëpo, mungesa e pranisë së ministrave është duke pamundësuar funksionimin e nenit 26 të Rregullores së Re të Kuvendit¹⁶ – që krijon hapësirë solide për deputetët e interesuar që të parashtrorjnë pyetje parlamentare në adresë të kabinetit qeveritar. Kjo ka bërë që shumë deputetë të heqin shpeshherë dorë nga parashtrimi i pyetjeve dhe t'i përsërisin për të saten herë ato. Nga statistikave për periudhën Janar-Korrik rezultojnë që Kuvendi i Kosovës ka mbajtur 23 seancat plenare: 6 prej të cilave kanë qenë solemne. Në 20 seancat plenare janë parashtruar gjithsej 104 pyetje parlamentare, ndërkaq vetëm 41 prej tyre janë bërë për afëra të ndryshme korruptive. Nëse analizojmë kronologjikisht këto statistika, vërejmë se në janar janë bërë vetëm 2 pyetje për afëra korruptive, ndërkaq 11 tjera për çështje tjera. Ndërkaq, muaji më i zbehtë, përveç korrikut, është muaji shkurt, në të cilin janë bërë vetëm 5 pyetje për korrupsion, kurse 20 pyetje tjera janë bërë për çështje tjera, të cilat janë jashtë domenit të korrupsionit dhe krimin të organizuar. Në muajin mars janë realizuar 4 pyetje parlamentare për korrupsion dhe 9 pyetje për çështje tjera. Pra, muaji mars ka shënuar një rënie të interesimit për sa i përket diskutimeve për nivelin e lartë të korrupsionit dhe krimin të organizuar, kurse Prilli ka shënuar një rritje të interesimit të deputetëve: 12 pyetje për korrupsionin dhe 19 për çështje tjera. Ndërsa maji shënon menjëherë rënie: me vetëm 6 pyetje për afëra korruptive dhe 18 për çështje tjera. Ndërkaq muaji qershor karakterizohet nga një rritje: 12 pyetje për korrupsion dhe 21 për çështje tjera. E muaji pa asnjë pyetje parlamentare për korrupsion është korrik-u.

¹⁵ Raporti i Parajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010,

¹⁶ Neni 26 i Rregullores së Kuvendit të Kosovës, miratuar me 20 Maj 2005, e ndryshuar dhe e plotësuar me 1 Qershor 2006.

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

Statistikat shtatë mujore të pyetjeve për korrupsion dhe çështje tjera gjatë kohës së pyetjeve parlamentare:



Tab (1): Periudha Janar-Korrik e Pyetjeve Parlamentare

Ky pasivizim në ndërmarrjen e aktiviteteve dhe veprimeve të cilat do të kontrollin Qeverinë ka ndikuar që niveli i kënaqshmërisë së qytetarëve me punën e Kuvendit të pësoi rënie në 33%.¹⁷ Kjo përqindje tregon një krizë të thellë legjitimiteti dhe besueshmërie në Legjislativin e vendit – i vetmi organ i zgjedhur drejtpërdrejt nga qytetarët e Kosovës. Në kuadër të kësaj kohe për pyetje parlamentare, më të zëshmit dhe më të interesuarit për të denoncuar afere të ndryshme

korruptive janë deputetët e pavarur: Driton Tali dhe Naim Rrustemi. Gjatë periudhës Janar-Korrik, Driton Tali ka bërë gjithsej 13 pyetje parlamentare për korrupsion, ndërkaq në vendin e dytë është Naim Rrustemi me 10 pyetje parlamentare për afere të ndryshme korruptive. Riza Smaka, nga radhët e AKR-së, ka bërë gjithsej 5 pyetje për korrupsion dhe Xhynaze Sylja, nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës vetëm 2 pyetje. Ndërkaq deputetët me nga një pyetje janë: Donika Kada-Bujupi, Ibrahim Selmani, Shkumbin Demaliaj, Qamile Morina, Suzan Novobrdaliu, Myrvete Pantina, Nait Hasani, Ibrahim Makolli, Njomza Emimi dhe Abyl Imeri,

¹⁷ Raporti i Parlajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 1. Sipas këtij Raporti, kënaqëshmëria me punën e Kuvendit ka rënë për rreth 13% që nga shtatori 2009

Lista e deputetëve të cilët, gjatë kohës së pyetjeve parlamentare, kanë parashtruar pyetje më së shumti për korrupsion.



Tab (2): Statistika e pyetjeve parlamentare për korrupsion në periudhën Janar-Korrik 2010

Kështu që Kuvendi i Kosovës, në vend që të miratojë ligje që rregullojnë përfitimet e tyre personale (siç është pensioni suplementar), duhet të angazhohet seriozisht për miratimin ligjeve tjera më rëndësi përmbajtjesore, siç janë: Ligji për Financimin e Partive Politike, Ligji Anti-mafia dhe Ligji për Shpëlarjen e Parave. Këto ligje do të etalonin kornizën ligjore anti-korrupsion, gjë që lufta ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar do të intensifikohej edhe më shumë.

SISTEMI GJYQËSOR

Njëra ndër pushtetet më të rëndësishme, të cilitdo sistem politik, është edhe pushteti gjyqësor. Ky pushtet, nëse është i paanshëm dhe i pavarur, atëherë apriori siguron dhe kufizon çdo lloj mundësie për shpërdorim të parasë publike apo të pozitës zyrtare. Në këtë kontekst, njëra nga arsyt

pse korrupsioni dhe krimi i organizuar është shtrirë gjithandej institucioneve, është edhe zhytja e vet sistemit gjyqësor në korrupsion dhe rënia e tij në grackën e presioneve dhe interferencave politike. Një konstatim të tillë e konfirmon edhe Raporti i fundit i EULEX-it, i cili thekson se sistemi i drejtësisë në Kosovës ende tregon shenja të dobësisë. Më tutje thuhet se interferencat në nivele të ndryshme dhe në forma të llojllojta janë evidentuar.¹⁸ Gjyqësori i Kosovës vazhdon të jetë institucioni që qytetarët janë më së paku të kënaqur. Edhe Raporti i Paralajmërimit të Hershëm kishte regjistruar një rënie prej 10% që shënon nivelin më të ulët të regjistruar ndonjëherë.¹⁹ Prandaj, meqë demokracitë assesi nuk mund të funksionojnë pa sistemin gjyqësor, ngase garanton dhe kontrollon pushtetet tjera, atëherë edhe Kosova duhet të ndërmarrë hapa të shpejtë dhe seriozë për reformimin e thellë të saj.

¹⁸ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 9

¹⁹ Raporti i Paralajmërimit të Hershëm, UNDP Kosovë, 27 mars, 2010, fq. 2


MONITORUESI I KORRUPSIONIT

PROKURORIA E KOSOVËS, e cila vepron në kuadër të sistemit gjyqësor, për herë të parë është involuar në kundërvënien e korrupsionit dhe krimin të organizuar. Task-Forca, e cila ishte themeluar në shkurt të këtij viti dhe e cila operon në kuadër të Prokurorisë Speciale, është funksionalizuar me rastin e arrestimit më të madh të një zyrtari të lartë që nga periudha e pas-luftës: Governorin e Bankës Qendrore të Kosovës, Hashim Rexhepi. Governori në fjalë është akuzuar për keqpërdorimet me polisa kufitare, korrupsion, marrje rryshfeti, shmangie nga tatimi dhe shpëlarje parash.²⁰ Në këtë aksion kanë pjesë vetëm prokurorët vendorë dhe Policia e Kosovës, duke shënuar një zhvendosje të luftës së korrupsionit nga mekanizmat ndërkombëtarë në ata vendorë. Ky është një hap i rëndësishëm dhe përmbajtësor për të ndriçuar një dekadë keqpërdorimesh të bëra në sistemin bankar dhe atë të sigurimeve. Përveç bastisjeve që kanë ngjarë në BQK, është bastisur po ashtu edhe shtëpia e Ibush Mazreku-t, i cili aktualisht punon në postin e drejtorit në kompaninë e sigurimeve Dardania. Në ndihmë të Governorit Rexhepi ka dalë edhe ish guvernatori i BQK-së, Michel Svetchine, i cili ka mbrojtur Rexhepin për akuzat dhe dyshimet e bazuara ndaj tij. Të gjashtë akuzat që janë duke rënduar mbi Governorin, sipas Svetchine, janë të pabazuara dhe assesi guvernatori Rexhepi nuk është i implikuar në ato. Kjo do të shtynte edhe Kryetarin e Kuvendit të Kosovës të deklaronte se askush nuk duhet të del në mbrojtje të keqbërësve. Përveç arrestimit të këtij “peshkaqeni”, duhet të arrestohen edhe të gjithë “peshkaqenët” tjerë, në mënyrë Kosova të pastrohet nga këta keqbërës, të cilët janë duke e dëmtuar seriozisht procesin e shtetndërtimit dhe demokratizimit të vendit tonë, Kosovës.

²⁰ Zekirja SHABANI: Arrestohet një peshkaqen, Express, 24 korrik 2010.

DOGANAT

Statistikat e Anti-korrupsionit të Doganave të Kosovës tregojnë se janë shqiptuar 4 masa disiplinore dhe 4 masa tjera suspenduese për keqpërdorim të detyrës zyrtare. Në kuadër të masave disiplinore hyjnë 1 vërejtje me shkrim, 1 ndalim promovimi, 1 anulim performanse dhe 1 transfer në detyrë tjetër. Ndërkaq, në Sektorin e Standardeve Profesionale janë suspenduar katër zyrtarë për shkak të shpërdorimit të detyrës zyrtare.



Tab (3). Statistikat e rasteve për afere korruptive të muajit korrik 2010

POLICIA E KOSOVËS


Policia e Kosovës vazhdon edhe më tutje të perceptohet nga qytetarët e Kosovës si institucioni më i besueshëm dhe më pak i korruptuar. Rreth 76% e qytetarëve (përkundrejt 72% në shtator 2009) e të intervistuarve kanë qenë të kënaqur me punën e Policisë së Kosovës dhe vetëm një përqindje e vogël

mendojnë se korrupsioni është i pranishëm në Policinë e Shtetit. Edhe Raporti i fundit i EULEX-it pati treguar një shkallë progresioni të Policisë së Kosovës në relacion me kundërvënien ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar²¹. Gjatë muajit korrik Policia e Kosovës ka filluar fushatën e quajtur “Të gjithë së bashku në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit”. Përmes kësaj fushatë mëtohet të sensibilizohet opinioni i gjerë për të raportuar për rastet korruptive që qytetarët hasin në kontakt me policët e Kosovës. Përveç kësaj, Policia e Kosovës ka lansuar edhe adresën e saj elektronike (indo@kosovopolic.com) dhe nr. e telefonit (038550999), ku në çdo kohë mund të kontaktohen. Policia e Kosovës ka arrestuar edhe një zyrtar të Pylltarisë në Pejë, i cili kishte kërkuar rryshfet pronarit të Kompanisë së Përpunimit të Drurit “Lyboteni”, mirëpo gjyqtari i Gjykatës Komunale në Pejë e kishte liruar atë, ani pse kishte prova të mjaftueshme për burgosjen e tillë. Pas një skandali të tillë, Lëvizja FOL ka reaguar përmes një komunikate dhe një letre dërguar Kryesuesit të KGJK-së, Enver Peci. Ndërkaq, sa i përket rasteve me të cilat Drejtoria për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsion (DHKEK) është duke u marrë, ka mbetur që në Raportet e ardhshme të evidentohet sesa është proceduar me rastet që janë duke u hetuar për korrupsion dhe krim të organizuar.

RAPORTIMET E GAZETAVE

Të gjitha gazetat e monitoruara nga stafi i Lëvizjes FOL, të cilat pasqyrojnë zhvillimet e gjithmbarshme në Kosovë, shpërfaqin një nivel të lartë të korrupsionit dhe krimit të organizuar. Ndonëse shumica e raportimeve të mediave janë të përqendruara në lajme, në mesin e tyre ekzistojnë gazeta që realizojnë edhe tema të ndryshme, të cilat më pastaj janë ngritur në nivel të debatit. Nga 177 artikuj të publikuar nga gazetat e përditshme (Koha Ditore, Zëri, Kosova Sot dhe Expressi), 62 janë tema, ndërkaq 115 prej tyre janë lajme. Gjatë muajit korrik Koha Ditore ka realizuar 33 lajme dhe 19 tema për çështje të korrupsionit. Gazeta Zëri ka realizuar 32 lajme dhe 13 tema për afera të ndryshme korruptive. Kosova Sot me 27 lajme dhe 21 tema. Gazeta Express, e cila me 23 lajme dhe 9 tema.

Raportimet e medieve për korrupsion



²¹ Program Raporti 2010: Ndërtimi i Përbashkët i Ndryshimit të Qëndrueshëm, EULEX, qershor 2010, fq. 13-23

RAPORTET NGA SHOQËRIA CIVILE

Edhe shoqëria civile në Kosovë, e cila pranohet gjerësisht se është esenciale për proceset demokratizuese në vendin tonë, ka ndërmarrë një sërë aktivitete në luftë kundër korrupsionit dhe praktikave tjera korruptive. Qëllimi i aktiviteteve të shoqërisë civile, përkatësisht e organizatave jo-qeveritare, ka qenë denoncimi i praktikave korruptive dhe deformuese të keq-qeverisjes. Në këtë kontekst, gjatë muajit qershor janë shënuar dy aktivitete të ndryshme nga dy organizata të ndryshme.

LËVIZJA FOL - Gjatë këtij muaji ka organizuar një tryezë të rrumbullakët: “Konflikti i Interesit”, në të cilën është prezantuar edhe lista e deputetëve të cilët janë në konflikt interesi – duke mbajtur dy e më shumë funksione publike. Sipas panelistëve të ftuar është shprehur domosdoshmëria që zyrtarët e lartë publikë të heqin dorë nga postet që janë anti-kushtetuese dhe anti-ligjore. Deputeti Naim Rrustemi, i cili ishte në cilësinë e panelistit, ka pohuar që Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit ndalon deputetët të ushtrojnë funksione tjera, përveç veprimtarisë shkencore, sportive dhe realizimin e të drejtave të autorit dhe patentave. Gjatë këtij muaji Lëvizja FOL ka reaguar edhe ndaj vendimit të Qeverisë së Kosovës për zgjedhjen e Naser Osmanit në cilësinë e anëtarit të AKP (Agjencia Kosovare e Privatizimit) dhe propozimit të saj që edhe deputeti tjetër, Slobodan Petrovic, të jetë anëtar i AKP-së.

INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS - Edhe KDI ka publikuar Raportin e saj gjashtëmuor (janar-qershor) në muajin korrik në lidhje me punën dhe funksionimin e Kuvendit të Kosovës. Sipas këtij Raporti, deputeti më aktiv ka qenë Riza Smaka, ndërsa deputeti më pasiv ka qenë Enver Hoxha, ministër në MASHT. Mungesa e kuorumit dhe mungesa e ministrave në këto seanca kanë qenë kritikë e këtij Raporti. Edhe Komisionet

Parlamentare, sipas KDI-së, nuk i kanë respektuar afatet kohore për procedimin e projekt-ligjeve dhe kanë monitoruar një numër të vogël të ligjeve.

INSTITUTI BALLKANIK I POLITIKAVE – IPOL ka publikuar Raportin e saj tremujor në lidhje me performansën e EULEX-it. EULEX-i, sipas këtij Raporti, ka realizuar aksionet e tij të bastisjes si nevojë e përmirësimit të imazhit, por në të njëjtën kohë edhe i ka rritur pritjet e qytetarëve për sa i përket luftës kundër korrupsionit. Sipas IPOL duhet që EULEX-i të dalë me rezultate konkrete në luftë kundër korrupsionit, sepse në fund të fundit rezultati është më rëndësi.²²

FALËNDERIME

Publikimi i këtij Raporti u mundësua nga USAID përmes Programit për Fuqizimin e Shoqërisë Civile i implementuar nga ISC – Instituti për Komunitete të Qëndrueshme (Institute for Sustainable Communities). Ky Raport, po ashtu, është produkt dhe rezultat i kontributit të një ekipi të përkushtuar, si nga stafi i lëvizjes FOL, por edhe nga bashkëpunëtorët e jashtëm. Në këtë kontekst, Lëvizja FOL falënderon publikisht të gjithë personat që punuan në sigurimin e informacioneve dhe përpilimin e këtij raporti. Të gjitha Raportet e Lëvizjes FOL mbi Aktivitetet e Institucioneve Publike të Kosovës në Luftë kundër Korrupsionit janë të publikuara në këtë webfaqe: www.monikorr.org

RRETH LËVIZJES “FOL”

Lëvizja FOL angazhohet për të fuqizuar ndikimin qytetar në vendimmarrje, për qeverisje të përgjegjshme dhe efikase. FOL është thellësisht e përkushtuar që të punojë në përmirësimin dhe arritjen e niveleve më të mira të përfaqësimit qytetar në jetën publike. FOL punon për qeverisje të

²² Uran KRASNIQI: IPOL-i EULEX-it: Pa deklarata ambicioze, nwse s’ka rezultate, 18 korrik, 2010, fq. 2

MONITORUESI I KORRUPSIONIT

mirë dhe të bazuar në parimet demokratike, për institucione të përgjegjshme, transparente dhe llogaridhënëse, si dhe për zbatim dhe hartim të ligjit me pjesëmarrje. Prandaj, shpenzimi i fondeve publike, konfliktit të interesit, neglizhenca dhe përgjegjësia institucionale, si dhe qasja në informacione zyrtare, përbëjnë çështjet kryesore të punës së FOL. Në përmbushje të këtyre qëllimeve, FOL mëton të luftojë apatinë dhe indiferencën qytetare si dhe ta bëjë më aktiv dhe më të dëgjueshëm zërin e qytetarit; ta bëjë atë pjesë aktive të interesit të komunitetit dhe përherë të gatshëm që t'i kundërvihet abuzimit, keqpërdorimit, korrupsionit dhe formave tjera deformuese të qeverisjes.

KONTAKTO:

Andrea Gropa 29, 100000 Prishtinë,

Republika e Kosovës

Mob: +377 (0) 44 131 542

Ueb: levizjafol.org

E-mail: info@levizjafol.org